



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1609/9 prot.

Datë 23.08.2023

V E N D I M
Nr. 805 /2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.08.2023 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt: “Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Genius” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-71354-06-01-2023 me objekt “Blerje Kite, Reagente dhe Materiale Konsumi për Laboratorin, e ndarë në 4 Lote”, **LOTI 4:** “Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi për laboratorin për aparatën Maglum 800 / ose ekuivalent i tij”, me fond limit 8,532,900.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.1.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Sëissmed” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.”

Ankimues: Operator ekonomik “Genius” SHPK
*Tiranë Kavajë Lagjja Nr.3, Rruga Jurgen Trade,
Laboratori përballë ish Spitalit*

Autoriteti Kontraktor: Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.1
Rr. “Vllazen Huta”, Tiranë

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “Swissmed” SHPK

*Njësia Bashkiake nr.11, Rruga Dritan Hoxha, Ndërtesa 92,
seksioni 4, Hyrja 28, Kodi Postar 1026, zona kadastrale
Nr.8310 Tiranë.*

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.06.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-71354-06-01-2023 me objekt “Blerje Kite, Reagente dhe Materiale Konsumi për Laboratorin, e ndarë në 4 Lote”, **LOTI 4**: “Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi për laboratorin për aparatën Maglum 800 / ose ekuivalent i tij”, me fond limit 8,532,900.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.1.

II.2. Në datën 20.06.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 05.07.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|--------------------|-----------------------------|
| 1. “Swissmed” SHPK | 7.600.000 lekë, kualifikuar |
| 2. “Genius” SHPK | 8.200.050 lekë, kualifikuar |

II.4. Në datën 05.07.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 61, datë 10.07.2023.

II.5. Në datën 10.07.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3253 dhe me nr. 1609/2023 prot., datë 10.07.2023 e operatorit ekonomik “Genius” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, konstatohet, se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Genius” SHPK, si dhe kualifikimin e operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK.

Pretendimet janë si më poshtë vijon:

2.7 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim për lotin nr. 4

Saktësisht duke cituar nga DST pikën 2.8.2

2.8.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim të leshuar nga Prodhuesi ose Distributori Zyrtar i Autorizuar/MAH/(ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se autorizohet të tregtoje për autoritetin kontraktor specifik, materialet mjekësore objekt-prokurimi. Autorizimi duhet të jete i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave; dhe origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara.

Po kështu në dokumentin e argumentimeve të kritereve, është pika e cituar:

2.4.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim të leshuar nga Prodhuesi ose Distributori Zyrtar i Autorizuar/MAH/(ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se autorizohet të tregtoje për autoritetin

kontraktor specifik, materialet mjekesore objekt prokurimi. Autorizimi duhet te jete i vlefshëm ne momentin e hapjes dhe dorëzimit te ofertave; dhe origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbi kërkesën e autorizimit të prodhuesit është konform VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi

Këtë pikë operatori ekonomik Swissmed, nuk mund ta plotësojë pasi i vetmi distributor i autorizuar nga prodhuesi Snibe për autoritetin kontraktor specifik Qendra Shëndetësore e Specialiteteve n.1, me materialet mjekësore objekt prokurimi për Maglum 800 është Genius SHPK, sic vërtetohet edhe nga letra e autorizimit të paraqitur prej nesh në këtë procedurë ku specifikohet qartë që ne jemi të vetmit distributor të autorizuar për të furnizuar këtë institucion. Pra, kemi të bëjmë me një shkëlqje të vet kriterëve të vendosura dhe të publikuara nga autoriteti kontraktor, ku të drejtën e furnizimit për këtë autoritet kontraktor e kemi ne nga kompania prodhuese, autorizim i lëshuar vetëm për operatorin ekonomik Genius SHPK.

Po kështu i drejtohem edhe pikës 2.8.6. cituar si më poshtë:

2.8.6 Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar te pakten 1 inxhinier te diplomuar ne profilin Inxhinieri Elektronike/ Elektrike/ Mekanike/ Informatike/ Mjekesore, gjithashtu te jete i trajnuar per pajisjet laboratorike pasi do te jete pergjegjes per instalim, trajnim te stafit mjekesore dhe kalibrimin e materialeve.

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojces 8 te DST.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve**, të gjithë dokumentacionin provues (kontratën e punës, diplomën përkatëse si dhe listëpagesën e shoqërisë për muajin e fundit për vetëdeklarimet mbi punonjësën e kërkuar në DST.

Pavarësisht se kjo pikë përmbushet me formularin përmbledhës së vetdeklarimit për një inxhinier të punësuar, këtu kemi të bëjmë dhe me një faktor shumë të rëndësishëm që është trajnimi, fakti që inxhinieri duhet të jetë i trajnuar për pajisjet laboratorike në fjalë. Inxhinieri jonë është i trajnuar dhe i pajisur me certifikatë nga vetë firma prodhuese që nga viti 2012, siç vërtetohet dhe nga certifikata e hedhur prej nesh në dokumentet e tenderit.

Po kështu autoriteti kontraktor ka publikuar që arsyeja e skualifikimit tonë është që oferta nuk është plotësuar por çdo dokument i kërkuar në DST është paraqitur dhe hedhur nga ne në sistem dhe njëkohësisht formulari i ofertës ka qenë i rregullt dhe është dorëzuar”.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 1609/2 prot., 10.07.2023 arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues si dhe duke referuar kriteret të cilat operatori ekonomik “Genius” SHPK, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik pjesëmarrës “Sëissmed” SHPK në këtë procedurë prokurimi.

II.7. Me anë të shkresës Nr. 521 prot., datë 18.07.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr. 1609/3 prot., datë 19.07.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

II.8. Me qëllim shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, me anë të shkresës nr. 1609/4 prot., datë 25.07.2023, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor informacion si më poshtë: “...Në vijim të shqyrtimit të ankesës me nr. 1609/2023 protokollin të operatorit ekonomik “Genius” SHPK, për kualifikimin e operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK, në procedurën e prokurimit [...]

Në pikën 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ligjvënësi ka parashikuar se “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ju lutem të paraqisni pranë KPP-së, brenda ditës nga marrja dijeni e kësaj shkrese, dokumentacionin e plotë të dorëzuar pranë autoritetit tuaj kontraktor, nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK, në mbështetje të pikës 6 të nenit 26 të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.”

II.9. Me anë të shkresës Nr. 531 prot., datë 28.07.2023, protokolluar me tonë me nr. 1609/5 prot., datë 31.07.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK, gjithsej 219 faqe.

II.10. Gjithashtu, me anë të shkresës nr. 1609/6 prot., datë 25.07.2023, Komisioni i Prokurimit Publik i ka ri-kërkuar autoritetit kontraktor informacion si më poshtë: “...informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, mënyrën e komunikimit me operatorin ekonomik të

kualifikuar i pari “Swissmed” SHPK për dorëzimin e dokumenteve, si dhe dokumentacionin e plotë në origjinal ose në kopje të njehsuar me origjinalin, të dorëzuar pranë autoriteti kontraktor, vetëm sa i takon plotësimin të kriterëve të kualifikimit të përcaktuar në shtojcën 7, Kërkesat të tjera të veçanta për lotin nr. 4, pika 2.8.2. dhe pika 2.8.8.

II.11. Në datën 02.08.2023 pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1609/7 prot., datë 02.08.2023 e operatorit ekonomik “Genius” SHPK.

II.12. Me anë të shkresës nr. 559 prot., datë 03.08.2023, protokolluar me tonë me nr. 1609/8 prot., datë 04.08.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin dhe dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK, gjithsej 214 faqe.

II.13. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e autoritetit kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të tjera të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit paraprak të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Genius” SHPK, për kualifikimin e operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK me pretendimin se:

“Saktësisht duke cituar nga DST pikën 2.8.2.

2.8.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim të lëshuar nga Prodhuesi ose Distributori Zyrtar i Autorizuar/MAH/(ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se autorizohet të tregtojë për autoritetin kontraktorik specifik, materialet mjekësore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave; dhe origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara.

Po kështu në dokumentin e argumentimeve të kriterëve, është pika e cituar:

2.4.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim të lëshuar nga Prodhuesi ose Distributori Zyrtar i Autorizuar/MAH/(ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se autorizohet të tregtojë për autoritetin kontraktorik specifik, materialet mjekësore objekt prokurimi. Autorizimi duhet të jetë i

vlefshem ne momentin e hapjes dhe dorëzimit te ofertave; dhe origjinale ose fotokopje te perkthyer dhe te noterizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbi kërkesën e autorizimit të prodhuesit është konform VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi

Këtë pikë operatori ekonomik Sëismed, nuk mund ta plotësojë pasi i vetmi distributor i autorizuar nga prodhuesi Snibe për autoritetin kontraktor specifik Qendra Shëndetësore e Specialiteteve n.1, me materialet mjekësore objekt prokurimi për Maglum 800 është Genius SHPK, sic vërtetohet edhe nga letra e autorizimit të paraqitur prej nesh në këtë procedurë ku specifikohet qartë që ne jemi të vetmit distributor të autorizuar për të furnizuar këtë institucion. Pra kemi të bëjmë me një shkelje të vet kriterëve të vendosura dhe të publikuara nga autoriteti kontraktor, ku të drejtën e furnizimit për këtë autoritet kontraktor e kemi ne nga kompania prodhuese, autorizim i lëshuar vetëm për operatorin ekonomik Genius SHPK.

”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përrjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.”, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës me nr. 1609 prot, datë 10.07.2023, paraqitur nga operatori ekonomik “Genius” SHPK SHPK ka lidhje me vendimet dhe veprimet e autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Akoma më tej, referuar nenit 118, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet se: “2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji; b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore; ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave

2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji; d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik. 3. Pas lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: a) të deklarojë absolutisht të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e këtij ligji; b) të urdhërojë autoritetin kontraktor për shkurtimin e kohëzgjatjes së kontratës dhe të kërkojë ndërprerjen e parakohshme të saj; c) të marrë një vendim deklarativ, në bazë të të cilit pushteti gjyqësor mund të dëmshpërblejë ankuesin, që ka pësuar humbje ose dëme si rezultat i shkeljes së këtij ligji”, Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

III.1.2. Marrë shkas nga arsyeja e kualifikimit të operatorit ekonomik pjesëmarrës “Sëessmed” SHPK dhe pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Genius” SHPK, nga verifikimi i kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilit është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se ky kriter është hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, pasi shkakton kufizim e cenon konkurrencën, duke kufizuar pjesëmarrjen e ofertuesëve në mënyrën e përmbushjes së tij, si dhe nuk i shërben autoritetit kontraktor. Konkretisht KPP vëren se:

III.1.3. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pika 2.8.2, “2.7 Kërkesa Të Tjera të Veçanta Për Kualifikim Për Lotin Nr. 4”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.8.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim të lëshuar nga Prodhuesi ose Distributori Zyrtar i Autorizuar/MAH/(ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se autorizohet të tregtojë për autoritetin kontraktorik specifik, materialet mjekësore objekt-prokurimi. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave; dhe origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara.

III.1.4 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike si dhe informacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor rezulton, se operatori ekonomik “Swissmed” SHPK në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur:

-Letër Autorizimi nga prodhuesi Snibe Co Ltd, të marrë më 01.01.2023 dhe të vlefshme deri më 31.12.2023, në të cilin evidentohen materialet mjekësore objekt-prokurimi.

III.1.5. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.6. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.7. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai

barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

KPP konstaton, se duke u kthyer tek ankesa e paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, një nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Genius” SHPK ka të bëjë përkatësisht me pretendime për mospërmbushjen nga ana e operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK të kriterit, *“Autorizim të lëshuar nga Prodhuesi ose Distributori Zyrtar i Autorizuar/MAH/(ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit konfirmohet se autorizohet të tregtojë për autoritetit kontraktorik specifik, materialet mjekësore objekt-prokurimi. Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes dhe dorëzimit të ofertave; dhe origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara..*

KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në hartimin e kriterëve në çdo rast duhet të ketë parasysh elemente të tilla si proporcionaliteti me objektin e kontratës, dobishmëria dhe nevoja që dikton vendosjen e kërkesës. Në rastin konkret KPP vëren, se te kërkesa për disponueshmërinë e autorizimit të lëshuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar, nëpërmjet të cilit konfirmohet që autorizohet të tregtojë materialet mjekësore objekt-prokurimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar për më tepër të përcaktohet edhe emri i autoritetit kontraktor specifik, e cila nuk i shërben autoritetit kontraktor. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në vendosjen e këtij kriteri, ka kufizuar numrin e pjesëmarrësve, duke ulur konkurrencën dhe duke sjellë pabarazi në rrethin e ofertuesve të interesuar për këtë

procedurë prokurimi. Në rastin konkret, KPP vlerëson, se kriteri i mësipërm ka shkelur një ndër parimet e mësipërme, atë të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, parim i cili është një parakusht *sine qua non* i realizimit të objektit dhe qëllimit të vetë ligjit për prokurimin publik, atë trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë, si edhe të sigurimit të integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor gjatë hartimit të kriterit të dokumenteve të prokurimit objekt-ankimi, duhet të kishte pasur parasysh parashikimet ligjore e konkretisht, neni 2 dhe neni 3 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar. Në këto kushte, KPP gjykon, se kriteri sa më sipër i hartuar nga autoriteti kontraktor, duke mos iu referuar dispozitave në fuqi lidhur me pajisjen me autorizimit të lëshuar nga prodhuesi ose distributor i autorizuar, nëpërmjet të cilit konfirmohet që autorizohet të tregtojë materialet mjekësore objekt-prokurimi, ka shkaktuar pabarazi në vlerësimin e ofertuesve dhe njëherazi ka vështirësuar punën e KVO-së, duke qenë të kushtëzuar të bëjnë vlerësimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Vlen të theksohet, se kriteret e kualifikimit, nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen, të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim kryerjen e një vlerësimi të drejtë dhe jo diskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi. Mospërcaktimi i saktë i kriterit, shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit.

III.1.10. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, *Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenin 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...] Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimitarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]*”, gjykon se hartimi i kriterit të kualifikimit jo në përputhje me aktet ligjore/nënligjore në fuqi përbën shkak për anulimin e kësaj procedure prokurimi. Në këtë kuptim autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Genius” SHPK për skualifikimin e ofertës së tij dhe kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që procedura e prokurimit objekt-ankimi do të anulohet, pretendimet mbi

shqyrtimin e arsyeve të tjera të palës ankimuese, nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Genius” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-71354-06-01-2023 me objekt “Blerje Kite, Reagente dhe Materiale Konsumi për Laboratorin, e ndarë në 4 Lote”, **LOTI 4**: “Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi për laboratorin për aparatën Maglum 800 / ose ekuivalent i tij”, me fond limit 8,532,900.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 20.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shëndetësore e Specialiteteve Nr.1.
 2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Genius” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

